

KOALICIONI PËR KOMRA-në

DRAFT STATUTI

**I KOMISIONIT RAJONAL PËR PËRCAKTIMIN E
FAKTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS DHE SHKELJEVE
TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË
HAPËSIRAT E JUGOSLLAVISË SË DIKURSHME**

Neni 6.

Periudha e veprimit

1. Periudha e veprimit të Komisionit është tri vjet.

(...) mendoj se nuk do të arrihet shumë për tri vite. (Zijad Nuhanović, Shoqata për kthimin e qëndrueshëm Podrinje dhe Zvornik, Zvornik, BeH, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

2. Periudha e veprimit të Komisionit nuk përfshinë periudhën e përgatitjeve, e cila fillon nga mbledhja konstituive dhe vazhdon, më së gjati gjashtë muaj.
3. Komisioni mund ta vazhdojë (zgjasë) periudhën e veprimit më së shumti për gjashtë muaj.

PJESA E IV. – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISONIT

Neni 12.

Qëllimet e Komisionit

Komisioni ka këto qëllime:

- (a) të vërtetojë faktet për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, në periudhën nga 1 Janari i vitit 1991 deri më 31 Dhjetor të viti 2001, rrethanat shoqërore dhe politike të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve të të drejtave;

Sipas mendimit tim, këtu do të duhej të shkruhej të mbledhë të dhënat për vërtetimin e fakteve, ndërsa faktet do ti vërtetojë organi kompetent i institucioneve në shtete. (Željko Špelić, oficer nderi Kroat, Pakrac, Kroaci, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

- (b) të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në shtetet kontraktuese të pranojnë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.
- (c) të kontribuojë në ndriçimin e fatit të humburve – pagjeturve;
- (d) të pranojë padrejtësitë e shkaktuara ndaj viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe bashkëndjenjës për viktimat;
- (e) të kontribuojë në realizimin e të drejtës së viktimave; dhe
- (f) të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Neni 13.

Detyrat e Komisionit

Komisioni ka detyrat si në vijim:

- (a) të mbledhë të dhënat për rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës, të ofrojë përshkrimin detal të tyre, të paraqesë format e shkeljeve të të drejtave dhe pasojat e tyre;
- (b) të mbledhë të dhënat për fatin e të zhdukurve dhe të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse të cilat merren me gjetjen e të zhdukurve në shtetet nënshkruese;
- (c) të hartojë listën e humbjeve në njerëz:
 - i. të civilëve të cilët kanë humbë jetë apo të të zhdukurve në lidhje me luftën apo në forma tjera të konflikteve të armatosura; dhe
 - ii. të luftëtarëve të cilët kanë humbë jetë apo janë zhdukë në lidhje me luftën apo në forma tjera të konflikteve të armatosura;

(...) unë jam për ta bërë një listë të të gjitha humbjeve. Në atë listë (regjistër) mund të jenë civilët dhe ushtarët gjithashtu aty duhet të jenë, jo mund të jenë por duhet të jenë edhe shtetasit e huaj të cilët kanë marrë pjesë në këto konflikte. Ku do ti evidentojmë ata? Në po atë listë, gjithashtu edhe pjestarët e forcave ndërkombëtare. Ndërsa lista tjetër duhet të jetë regjistrimi i viktimave, para së gjithash viktimat e krimeve të luftës.. (Veljko Vičević, Shoqata e vullnetarëve dhe veteranëve të luftës nacionale, Zagreb, Kroaci, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draftin e statutit për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

Duhet të regjistrohen të gjithë ata të cilët janë vrarë. (Nermin Karačić, veteran nga Sarajeva, Sarajevë, BeH, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

(...) është e vështirë të dallohen se kush është vrarë si civil, e kush është vrarë si ushtarë. Megjithatë, duhet të evidentohen të gjitha viktimat. (Mevludin Plančić, oficer i ish APJ-së, veteran, Vršac, Serbi, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

- (d) të mbledhë të dhëna për vendet e mbylljeve në lidhje me luftën apo në forma tjera të konflikteve të armatosura, të personave të cilët janë arrestuar në mënyrë të paligjshme, u janë nënshtruar torturës dhe trajtimit jo njerëzorë, dhe të hartojë listën gjithëpërfshirëse të tyre duke mbrojt identitetin e tyre aty ku është e nevojshme;
- (e) [ALT. A: të hulumtojë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat bindshëm kanë kontribuar në shpërthimin e luftës apo formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe faktin e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut]

[ALT. B: të hulumtojë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat, duke filluar nga viti 1980, bindshëm kanë kontribuar në shpërthimin e luftës dhe të konflikteve tjera të armatosura, si dhe faktin e krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut];
- (f) të mbajë dëgjime publike të viktimave dhe personave tjerë për krimet e luftës dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- (g) të rekomandojë marrjen e masave të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe dëmshpërblimin për viktimat; dhe
- (h) Të hartojë, publikojë dhe ta paraqesë raportin përfundimtar në atë mënyrë që të mundësojë që raporti të arrijë deri te një rreth i gjerë i njerëzve në shtetet e ish territorit të Jugosllavisë.

PJESA E V. – KOMPETENCA E KOMISIONIT

Neni 14.

Periudha dhe territori i hulumtimit

Komisioni vërteton faktet për krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej 1. janar 1991 deri 31. dhjetor 2001, në territorin e shteteve të ish RSFJ-së, dhe hulumton

Për ne është shumë me rëndësi që luftërat janë zhvilluar në periudhën kohore prej vitit 1990, e jo prej vitit 1991, sepse viktimat e para në Kroaci kanë qenë në vitin 1990. (Bruno Čavić, Shoqata e vullnetarëve dhe veteranëve të luftës nacionale, Zagreb, Kroaci, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

(...) jo deri në vitin 2001, për shkak se numri më i madh i krimeve në Maqedoni ka ndodhë në vitin 2002, edhe pse ka qenë e nënshkruar Korniza e Marrëveshjes dhe ishte miratuar amnestimi. Të përfshihet edhe viti 2002. (Predrag Petruševski Bingo, Shoqata e veteranëve 2001, Kumanovë, Maqedoni, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

[ALT. A: hulumton rrethanat politike dhe shoqërore të cilat bindshëm kanë ndikuar në shpërthimin e luftës dhe të formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe faktin e krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut].

[ALT. B: rrethanat politike dhe shoqërore të cilat, duke filluar nga viti 1980, bindshëm kanë ndikuar në shpërthimin e luftës dhe formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe faktin e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut].

(...) Nëse duam të bëjmë diçka të mirë, atëherë vërtetë duhet ti eliminojmë të gjitha kufizimet [për hulumtimin e rrethanave politike dhe shoqërore]. Pse? Disa gjëra kanë ndodhë për shkak se shumë gjëra kanë filluar shumë më herët. (Bruno Čavić, Shoqata e vullnetarëve dhe veteranëve të luftës Nacionale, Zagreb, Kroaci, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

(...) koha nuk duhet të jetë e kufizuar [për hulumtimet e rrethanave politike dhe shoqërore]. (Nikola Grkov, Shoqata e veteranëve të ushtrisë, Kavardarc, Maqedoni, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

Nuk duhet kufizuar kohën (për hulumtimin e rrethanave politike dhe shoqërore). (Veljko Vičević, Shoqata e vullnetarëve dhe veteranëve të luftës nacionale, Zagreb, Kroaci, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

(...) periudha kohore duhet të kufizohet [për hulumtimin e rrethanave politike dhe shoqërore]. (Anđelko Kvesić, Shoqata e të burgosurve të kampeve të përqendrimit të Kantonit të Bosnjës së

mesme, Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, Busovaqë, BeH, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

(...) Nuk duhet të ketë kufizime statike, por duhet të mundësohen margjinat shtesë për veprim. Pra, mendoj se koncentrimi kryesorë i KOMRA-së, për shkak të efikasitetit, duhet të jetë një kohë e caktuar, e cila është propozuar në statut. (Lush Krasniqi, Shoqata e të zhdukurve “27 prill 1999”, Gjakovë, Kosovë, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

Unë jam për kufizimin e veprimtarisë së komisionit [për hulumtimin e rrethanave politike dhe shoqërore]. (Predrag Petruševski Bingo, Shoqata e veteranëve 2001, Kumanovë, Maqedoni, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

(...) Periudha kohore të mos kufizohet në mënyrë strikte, sepse ajo që ka ndodhë në periudhën prej 1990 deri 2001, dhe pas kësaj kohe, (...) kanë qenë pasojat e shumë ngjarjeve dhe ndodhive, të cilat kanë ndodhë shumë më herët. (Rrahim Limani, Shoqata e veteranëve të luftës të Ushtrisë Nacionale Çlirimtare, Shkup, Maqedoni, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

(...) Komisioni nuk do të duhej fare të diskutojë për shkaqet politike dhe shkaqet tjera të luftës, por të fokusohet në faktet e veprimit të krimeve. (Željko Špelić, njësia Kroate e nderit, pakrac, Kroaci Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

PJESA VI. – AUTORIZIMET E KOMISIONIT

Neni 16.

Marrja e deklaratave

1. Komisioni merr deklaratat për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut bazuar në kompetencës e saj nga shtetet, dëshmitarët, përfaqësuesit e institucioneve dhe kryesit e veprave.
2. Çdo person të cilit, Komisioni, ia dërgon ftesën është i obliguar që të jep deklaratë për Komisionin. Posaçërisht, viktimat nuk kanë obligim për të dhënë deklaratë pranë Komisionit për të vuajturit ose vuajtjet e anëtarëve të familjes.

3. Në rast se personi refuzon për ti dhënë deklaratë Komisionit, duke u thirr në detyrimin ligjor për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, zbatohen dispozitat e nenit 11, paragrafet 3 dhe 4 të këtij Statuti.
4. Dispozitat e ligjit për procedurën penale në shtetin kontraktues zbatohen në të drejtën e shkurtimit të dhënies së përgjigjes në çështjet e caktuara dhe lirimit nga detyrimi për të dëshmuar, si dhe çështje të tjera lidhur me marrjen në pyetje të personave, të cilat nuk janë të rregulluara me Statut të Komisionit.
5. Në kërkesë të dhënësit të deklaratës, Komisioni mund të mundësojë edhe dhënien e deklaratës në mbrojtje të identitetit.
6. Komisioni mund të lidhë marrëveshje të veçanta me shtetet nënshkruese për mënyrën e thirrjes së personave nga paragrafi 1. Nëse këtë e konsideron të përshtatshme [HRV.: leverdishme], Komisioni mund ti propozojë gjykatës kompetente që me procedurë urgjente të vendosë për zbatimin e masave për sigurimin e pranisë së personit, në pajtim me ligjin për procedurë penale të shtetit në të cilin personi është i regjistruar, gjegjësisht është me banim aty.

Komisioni nuk mund të ketë fuqinë, e as kompetencën paralele me gjykatësin hetues, apo me gjykatën e ndonjë shteti. Ajo mund të jetë vetëm një korrigjues dhe në bazë të vullnetit mund të ftojë njerëzit, prandaj duhet të lidheni me organizatat e veteranëve dhe luftëtarëve që tju ofrojnë në dispozicion informatat se cilët njerëz mund t'ua thonë se kush ka qenë atëherë atje, çfarë njësie ka qenë, cili ka qenë orari, që të arrini deri te ato të dhëna. (Bruno Čavić, Shoqata e vullnetarëve dhe veteranëve të luftës nacionale, Zagreb, Kroaci Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

(...) unë jam për qasjen në bazë vullnetare dhe me këtë do ta lehtësonim punën e komisionit, dhe neni 16. menjëherë do ti ketë të panevojshme paragrafët 2, 3, 4 dhe 6. Janë të panevojshme ndërsa do të mbeten paragrafët 5 dhe 7. (Željko Špelić, njësia Kroate e nderit, Pakrac, Kroaci Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

Unë nuk e shoh kuptimin nëse e lëmë në bazë vullnetare. Atëherë, si do ta ftojmë ish ministrin e mbrojtjes apo ish ministrin e punëve të brendshme? Mendoj se duhet ti lihet mundësia KOMRA-së që të bëjë marrëveshje me shtetet dhe shtetet apo institucionet mund ti ftojnë. (Mile Aleksoski, Qendra për Hulimtim dhe Krijim të Politikave, Shkup, Maqedoni, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)

7. Gjatë dhe pas dhënies së deklaratës para Komisionit, sipas nevojës, të sigurojë mbështetje psikosociale për viktimën.

8. Komisioni i merr deklaratat:

- a. në vendin e banimit të përhershëm apo të përkohshëm të dhënësit të deklaratës;
- b. në zyrat e Komisionit;
- c. në përfaqësitë diplomatike–konsullata të shteteve nënshkruese, nëse deklarata merret në shtetet e treta; dhe
- d. Në territorin e shteteve të treta, nëse kjo nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të atyre shteteve, në rastet kur viktima, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund t'i japin deklaratat në konsullatat apo ambasadat e shteteve nënshkruese.

Neni 23.

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

1. Anëtari/anëtarja e Komisionit është:

- (a) Shtetas/shtetase e shteteve kontraktuese;
- (b) Person me kualitete të larta morale, me integritet dhe autoritet, i përkushtuar dialogut tolerant dhe konstruktiv për zgjidhjen e kontesteve, i cili mund të gëzojë besimin në të gjitha shtetet kontraktuese, dhe
- (c) Person me aftësi psiko-fizike për kryerjen efikase dhe në kontinuitet të detyrave të anëtarit/anëtares së Komisionit.

2. Në shtetin kontraktues zgjedhet më së paku një grua, gjegjësisht më së paku një burrë, për anëtarë ose anëtare të Komisionit.

3. Në shtetin kontraktues, me rastin e zgjedhjeve të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, do të ketë përkushtim në sigurimin dhe përbërjen reprezentative etnike të komisionit, në atë mënyrë që krahas pjesëtarit/pjesëtares nga radhët e Bashkësisë më të madhe në numër, do të

mundohet që të zgjedhë edhe njërin/njërën ose më shumë pjesëtarë/pjesëtare nga bashkësia tjetër etnike, gjegjësisht nga bashkësitë tjera etnike në atë shtet kontraktues.

4. Anëtari/anëtarja e Komisionit mund të jetë personi:

- (a) i/e cili/a ka kryer funksion të shquar politik në dy vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhjen e anëtarit/anëtares për Komision, apo në periudhën kohore e cila përfshinë kompetencën e Komisionit;
- (b) Për të cilin ekziston dyshim serioz se është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave humanitare ndërkombëtare, apo e ka përkrahë, ndihmuar apo ka nxitë kryerjen e këtyre veprave, apo ka kontribuar në mosndëshkimin për këto vepra, apo ka qenë i lidhur ngushtë me personin e dënuar, akuzuar apo që është nën hetime për vepra të tilla.

Pra, t'i propozojmë grupit punues që ta heqë këtë pjesën për pozitën e shquara politike, dhe të thotë: se nuk mund të jetë personi nga asnjëra strukturë nëse për të ekzistojnë indikacione serioze, dyshime serioze se ka kryer vepra penale. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Këshilli Koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, Beograd, Serbi, Konsultimet rajonale me veteranët mbi draft statutin për KOMRA-në, Shkup, Maqedoni, 18 dhjetor 2010.)